

Gjykata Themelore Gjakovë- Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Haki Kryeziu, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtareve porotë Hatixhe Bashota dhe Musë Mazreku anëtar, si dhe sekretaren juridike Fatime Hoti, në çështjen juridike të paditësit P. K. nga fshati A. Komuna e Malishevës të cilin me autorizim e përfaqëson av,N. K. , kundër të paditues L. K. e lindur në fshatin S. Komuna e R. tani me vendbanim në fshatin Ll. Komuna e G., lidhur me besimin, ruajtjen, edukimin e fëmijëve të mitur si dhe kontaktet personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik me datë 18.01.2019, muar këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** Miratohet në tersi si e themeltë kërkesëpadia e paditësit P. K. nga fshati A. Komuna e Malishevës.
- II.** Fëmijët e mitur E. K. e lindur me datën ..., në P. dhe E. K. i lindur me datën,në P. si fëmijë i lindur nga bashkësia e përbashkët jashtëmartesore e ndërgjyqësve, **i besohet** në ruajtje, kujdes, edukim dhe ushqimi babait të tyre paditësit P. K..
- III.**Detyrohet paditësi P. K. nga fshati A. Komuna e Malishevës që pa kurrfarë pengese t'ia mundësoj të paditues L. K. e lindur në fshatin S. Komuna e R. tani me vendbanim në fshatin Ll. Komuna e G., kontaktin me fëmijët e tyre të mitur një herë në vit dhe atë nga 01 janar deri me 5 janar të vitit në vijim, kontaktet personale do të realizohen në shtëpinë e prindërve të të paditurës në fshatin S. Komuna e R..
- IV.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A R S Y E T I M

Paditësi i cekur si më lart me datën 16.08.2018 në këtë gjykatë parashtron padi kundër të paditues të lartpërmendur për besim, ruajtje, edukim, dhe ushqimi të fëmijve të mitur duke theksuar ndër tjerash se me të padituren kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore që nga viti 2007 deri në vitin 2013, në vitin 2007 ishin martuar së bashku sipas zakonisht por pa lidhur kurorën formale tek institucionet kompetente, pra kanë bashkëjetuar siç njihet edhe me ligjin mbi Familjen dhe Martesën të Kosovës. Gjatë kësaj bashkëjetese kanë të lindur fëmijet e tyre E. K. dhe E. K.. Në fillim kanë pasur raporte të mira në ndërkohë raportet në mesë të bashkëshortëve janë përkeqësuar ashtu që ata kanë vendosur të mos jetojnë së bashku dhe janë ndarë sipas traditave zakonore kurse fëmijet që nga ajo kohë jetojnë me babain e tyre P. K. nga fshati A. i cili tash punon në Gj., krijon të ardhura për vete dhe fëmijet e tijë kurse pas rregullimit të statusit të tijë dëshiron që me vete ti marrë edhe fëmijet e tijë në menyr që tu ofroj kushte më të mira të jetesës dhe shkollimit.

E padituri me përgjigjen në Padi të parashtruar me datë 14.01.2019 nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesë padinë,duke theksuar se pajtohem që fëmijët të udhëtojnë bashkë me prindin e tyre në Gj. apo kudo qoftë në botën e jashme për arsye se me ish bashkëshortin timë tani paditësin kam bashkëjetuar rreth pesë vite,dhe jemi ndarë.

Gjatë bashkëjetes son gjashtë vjeqare kemi lindur dy fëmijë E. dhe E. K. dhe prej se jemi ndarë fëmijët në vazhdimsi kanë jetuar me babain e tyre P. K.,dhe unë tash kam krijuar bashkësi të rë familjare dhe jam martuar me një person tjetër në fshatin Ll. Komuna e G..

Në seancën e shqyrtimit kryesor mbajtur me datë 18.01.2019 i autorizuari i paditësit ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadisë si dhe thënieve në padi duke shtuar se paditësi me të paditurën kanë jetuar në bashkësi jashtë martesore që nga viti 2007 deri në vitin 2013, dhe gjatë asaj martese kanë pasur të lindur fëmijët: E. dhe E. K. ,në ndërkohë raportet bashkëshortore janë keqësuar dhe tani jetojnë ndaras që nga viti 2013, paditësi jeton në Gj. ka të ardhura të mjaftueshme për mirëritjen e fëmijëve, ndërsa pas rregullimi të statusit dëshiron që edhe fëmijët ti marrë në Gj. dhe ti ofron kushte ma të mira të shkollimit, po ashtu edhe në fjalëen përfundimtare i autorizuari i paditësit ka mbetur në tërësi pranë kërkesë padisë ndërsa sa i përket kontakteve personale pajtohen të jen sipas propozimit të të paditurës dhe atë një herë në vit për festen e vitit të ri.

Ndërkaq në seancën e shqyrtimit kryesor e paditura ka theksuar se ka krijuar bashkësi të re familjare pasi që është martuar në fshatin Ll. Komuna e Gll. dhe nuk ka mundësi që të kujdeset për fëmijet e tyre, duke mos e kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa fëmijet e mitur ti besohen paditësit. E paditura është e pajtimit që fëmijët e mitur të udhëtojnë bashkë me prindin e tyre në Gj. atje ku edhe jeton vet paditësi. Në fjalëen përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe pretendimeve të parashtruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata administroi provat si në vijim; çertifikatën e lindjes me numër referencës ... me numër rendor ... të lëshuar me datën 03.08.2018, nga zyra e gjendjes civile në M., çertifikatën e lindjes me numër referencës ... me numër rendor ... të lëshuar me datën 06.08.2018, nga Zyra e Gjendjes Civile në M..

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të ndërgjyqësve dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje i çmoj çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe gjeti se:

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar

Nga leximi i certifikatave të lindjes për të miturit, E. K. e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në M. me datë 03.08.2018, E. K. e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në M. me datë 06.08.2018 gjykata e ka provuar faktin e lindjes për të dytë fëmijët e mitur të lindur me datë në P. dhe në P. dhe gjatë bashkësisë jashtëmartesore të atit të tij P.K. nga fshati A. Komuna e Malishevës dhe të ëmës L. K. nga fshati A. Komuna e M..

Pas vërtetimit të kësaj gjendje faktike, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk është kontestuese fakti se ndërgjyqësit kanë jetuar për një kohë në bashkësi faktike jashtëmartesore dhe se nga kjo bashkësi kanë lindur një fëmijët dhe ata E. K. dhe E. K., po ashtu nuk është kontestuese as fakti se për momentin këta fëmijë janë nën përkujdesjen faktike të babait këtu paditësit.

Nga e tërë kjo rezulton se palët kanë pajtueshmëri lidhur se kujt ti besohet fëmijet në përkujdesje, ruajtje, edukim dhe ushqimi si dhe kontakti i prindit me fëmijën ndërsa nuk dëshiroj të rifillojnë bashkëjetesën për arsyet e cekura më lartë.

Bazuar në nenin 139 paragrafi 1 dhe 144 të Ligjit për Familje të Kosovës, gjykata vendosi në këtë mënyrë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke marrë parasysh pajtueshmërinë e ndërgjyqësve, e sipas të cilit mes tjerash rekomandohet që kujdesi prindëror për fëmijët e mitur, ti besohet në ruajtje, edukim, dhe ushqimi babait këtu paditësit P. K. duke marrë parasysh faktin që babai i ka kushtet më të mira e po ashtu mundë të ia ofroj një kujdes më adekuat.

Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë vlerëson se në këtë moment, mënyra se si është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi sa i për ketë dhënies në besim për ruajtje, kujdes, edukim dhe ushqimi të fëmijëve dhe caktimi i kontaktit me prindin tjetër në këtë rast është në favor të interesave më të mirë të fëmijëve dhe gjithashtu është dëshirë dhe vullnet i shprehur nga të dy ndërgjyqësit në mënyrë të drejtpërdrejt si dhe në këtë gjykatë gjatë seances gjyqësore.

Gjithashtu lidhur me mënyren e mbajtjes së kontakteve personale të nënës me fëmijët në këtë rast të të paditues –nënës me fëmijën gjykata vendosi si dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar fillimisht në faktin se kontakti i nënës me fëmijët në këtë rast ka ndikim në zhvillimin e drejtë psikofizik të fëmijëve dhe faktin se mbajtja e kontakteve të fëmijës me prindin tjetër sa do pak e plotëson zbrastësin e jetës së ndarë dhe e mban më të qëndrueshme lidhjen emocionale mes tyre.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par.4 të ligjit procedurës Kontestimore, duke marrë parasysh faktin se asnjëra palë nuk i ka kërkuar ato.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të Ligjit Procedurës Kontestimore në lidhje me nenin 139 par.1, 144 par.1 dhe 145 të Ligjit për Familje të Kosovës.

Gjykata Themelore Gjakovë- Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,

C.nr.198/2018, më datë 18.01.2019.

**Sekretarja juridike
Fatime Hoti**

**Kryetari i trupit gjykues
Haki Kryeziu**

Udhëzim juridik: Meqenëse palët pas shpalljes së aktgjykimit kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, ky aktgjykim behet i formës së prerë me datë 18.01.2019.